Stinë pa diej

poezi

2010

Autori:

Lebit Murtishi

Redaktoi:

Kadri Sherifi

Lektor:

Zekë Krasniqi

Kopertina:

Kadri Sherifi

Shtypi:

>>IRIS<<

Strugë 2010

Tirazhi:

500 copë

Lebit Murtishi

Përgatiti për shtyp:

Kadri Sherifi

Lebit Murtishi

Stinë pa diej

poezi

Bashkudhëtar!..

mos pyet
ku i kam sytë
ti udhëtar
që fle nën hënë
e copëra dielli
ndërron...
mos pyet
për sytë e mi...
i ke ballit,
janë në ty...

22.09.2009 Bern

Çamëri!..

Të lidhën për një shekull
këmb` e duar
Të lidhën bij andartësh
të pabesë
Që nami kapedanëve të shuhet
Që emri veç ndër këngë të të mbesë...

Të lidhën e në plumba të përshkuan
Siç lidhën Arbërorët e Moresë,
Po mbete e pavdektë përmbi vdekje
O nder i Shqipërisë që s`di të vdesë!..

13.12.2009 Bern

Mbaj mend...

stinë pa diej
mbaj mend,

dhe ëndrra
të mbeturan
peng...

mbaj mend
yjtë tek piknin
e dheu tek digjej
mbaj mend...

10.11.2009 Bern

Kur Dheu i shenjtë kishte zjarr...

(Kadri Labënishtit)

ti zbrite nga kohë mitike
kur Dheu i shenjtë kishte zjarr,
e Dheut i dhe buzëqeshjet
që Dheu të qeshë veç pak...

ti mbive nga gjiri i Dheut
përngjashëm me zotërat e lashtë,
e nderi i Dheut kur deshti
nga gjiri i fale dhe gjak...

i fale pranverat e blerta
se Dheu i shenjtë kishte zjarr,
për vete i zgjodhe veç prangat
që ndere t`u bën` gjer në varr...

dhe ike një ditë me vjeshtën,
i qeshur si paqe e qielltë,
dhe ike se paqja të priste
në gjirin e Dheut të shenjtë

19.02.2010 Bern

Dy kapedanë!..

(dëshmorëve Fahri Fazliu & Afrim Zhitia)

kur buzëqeshja
vdista në pragje
e koha heshtte
si mumie e lashtë...

mbinë nga Dheu
nëpër tufanë
e ndezën qiellin
dy kapedanë...

02.06.2010 Bern

Gjurmë kohësh...

kur mbi lumenjë
të etur malli
përvaren kohët
që s`janë më

në shpirtin tim
kërkoj një tempull
t`i ndryj të gjitha
një nga një...

17.03.2010 Bern

Janinë...

ngado...dasmorë
me sy të ngrirë,
ngado një lule
mbi varr e mbirë...

ngado bashllëkë
varresh pa emër,
ngado hanxharë
ngullur në zemër...

ngado varganë
me shpirt ndër dhëmbë,
ngado një krismë,
ngado një gjëmë...

15.11.2009 Bern

Këng` e Besëlidhjes...

në ç`këngë ke zën` vend o Lezh` e lashtë,
në ç`këngë të bekuan perënditë,
në ç`këngë shtrove burrat në një sofër,
në ç`këngë i dhe zemër trimërisë...

në ç`këngë lidhe besë o Lezh` e lashtë,
në ç`këngë i dhe besë Shqipërisë,
në ç`këngë shenjtërove kastriotët
në ç`këngë i përkunde frashërllinjtë...

e ç`këngë të këndoj o Lezh` e lashtë,
për ty që të përgjakur ke çdo gur,
në ç`këngë të kujtoj përmasën tënde
që mblodhe Shqipërin` nën një Flamur...

13.12.2009 Bern

Këng` e popullit tim...

të heshtësh të than` o këngë
e të paqtë mort t`uruan...

...e u thurën vargje dimrash,
si gërshërë gjarpërinjësh,
e të iknin larg Pranverat
si mallkim prej perëndish...

të heshtësh të than` o këngë
e të paqtë mort t`uruan...

...kur gjëmove mbi gjëmime
e në ballë vure bijtë
e i hape udhë Pranverës
e shpërfille perënditë...

30.11.2009 Bern

“Ato bjeshkë janë tonat”1)

(dëshmorit Agim Ramadani)

se zjarri i fshehur i shpirtit
kish djegur dhe këngën dhe fjalën,
aq pak ligjërove për bjeshkët,
për bjeshkët që namin ta falën...

aq pak ligjërove për bjeshkët,
se bjeshkët nuk dijnë të flasin,
se bjeshkët dijnë të gjëmojnë,
se bjeshkët dijnë të buçasin...

seç kishe të flasësh me bjeshkët,
si bjeshka me bjeshkën e rëndë,
dhe fole me gjuhën e bjeshkës
me bjeshkët që bjeshkë të bënë...

1) janë fjalët e dëshmorit

09.03.2007 Neuhausen

Zemërova perënditë...

një jetë
mallkuar qèsh

një jetë
e përtej jete
i mallkuar qèsh
e mbeç

preka frutin
e parajstë
më mallkuan
perënditë...

27.11.2009 Bern

Jam koha ime...

kam diku në shpirt një zjarr,
kam një prush diku në gji,
as u plakç as mbeta djalë,
as matuf as haxhami...

jam aty diku mes kohësh,
jam model i kohës vet,
ku peshohet dhimbje botës,
ku peshohet turp e nder...

22.11.2009 Bern

Dhimbje arbërore...

sa këngë
në mes u prenë
e kurrë më
s`u kënduan...

sa dhimbje ka madhështia
Arbëri, veç ti e di...

15.11.2009 Bern

Baladë e fjalës...

po e the të shkretën fjalë,
që godet e pret si pallë
do të shajnë babë e nënë
pushtër, djaj e sharllatanë...

pushtër, djaj e sharllatanë,
lidhur qafat me kollare
çirren pallin si gomarë,
njohin veç vetën e parë

unë, unë e veç unë
qesh e jam e do jem unë,
dhe u thotë historia:
ju njoh mirë o firaunë...

22.11.2009 Bern

Kosovë!..

ti s`pate hise në qiellin
tënd
për dallëndyshet që vijnë
nga larg,

ti s`pate udhë të zgjedhësh tjetër
ti s`pate kohë të lësh` për nesër,

u ngrite peshë mbi carë e krajlë
dhe s`ngrite kurë flamur të bardhë.

03.06.2009 Bern

Qajnë dhe malet ndonjëherë!..

tim biri i ra një lot në faqe
dhe deshi tinëz ta fshijë pastaj
do qe i rëndë ky lot i fshehur
që s`mundi ndrydhur im bir ta mbaj!..

u ndje si foshnjë i zënë në faj
im bir që qau për herë të parë,
mbase s`qe lot, qe mall i marrë,
mbase qe ëndërr n`agim e vrarë!..

nuk di nga ç`kohë zbriti ky lot
që theu zemrën e birit tim,
veç pash që qau im bir si foshnjë
dhe qau thellë dhe shpirti im...

30.08.2009 Bern

Një ditë!..

një ditë do zgjohen malet,
do zgjohen udhë e sheshe,
do zgjohen dhe yjt e fjetur
se nën varre s`gjejnë prehje...

do marshojnë me pranverën
me flamuj të kuq mbi supe,
e do qeshin prapë sheshet,
e do qeshin lulëkuqet...

23.09.2009 Bern

Qëndroni o këmbë të mia!..

qëndroni, -u them o këmbë,
kemi udhë për të bërë,
kemi fjalë për të thënë,
kemi ëndrrën për ta shpënë...

mos më lini në mesudhë,
së paku dhe pak qëndroni,
gjer buzë varrit më afroni
pastaj ikni nga të doni!..

22.09.2009 Bern

Përpara ekranit…

Ja thoshte gërnetës me vargje
një mjeshtër i zeshkët pa emër
dhe vargjet e drithshëm të largët
fillova t`i ndiej në zemër...

dëgjoja timbrimin e largët
nga stinët që ikën e s`vijnë
dhe ika mes tingujsh e vargjesh
kërkoja të gjej fëmijërinë...

22.09.2009 Bern

Gërshetë e shprishur...

më erdhe një natë në ëndërr
si makth i tejbotshëm i frikshëm
dhe hiret e kohës së fikur
i fshihje në sytë e përlotur...

më more për dore me ndrojtje,
më fshehe nën pemën e vjetër
dhe yjet t`u ndezën mbi supe
tek shprishje nën hënë gërshetën...

ta preka gërshetën e shprishur
me mallin e ëndrrës së parë,
të ndjeva dhe erën e gushës
tek flije si foshnjë në barë...

21.11.2007-19.09.2009 Bern

Kënga ime...

kënga ime
ka ngjyra
e mall dallëndyshesh,

është erë jugu
në sy të tejzgjatur
shpresëtarësh...

kënga ime
është makth i përhertë
në sytë e përgjakta
të djallit....

17.09.2009 Bern

Makinë e shkrimit...

do heshtim një ditë,
do heshtin dhe fjalët,
do na vijnë te koka
me shami të marrët...

do na shajnë me ligje,
do na shajnë ndër dhëmbë,
për vargun e vrazhdë,
për fjalën e lënë...

po edhe nga qielli
do dërgoj një letër
ta marrin vesh mumiet
se ende s`kam vdekur...

13.07.2009 Bern

Natë e shurdhët...

sonte s`kam gjumë
e s`di ç`i mungon kësaj nate
                    më shumë
a zërat e mbytur të qenve
a klithjet e pista në udhë...

ndoshta kanë vdekur të gjithë,
ndoshta kam vdekur dhe unë...

13.07.2009 Bern

Klithmë stinësh!..

a ka kush
mbi këtë Dhé
t`i thot` pranverës
ja ku m`ke...

që vjeshta
e begat` të vi
e dimrat
pa stuhi!..

a ka kush
që del n`mejdan
e i thot` botës
“jam shqiptar”...

13.07.2009 Bern

O Zot!

kam lindur
kur deshe Ti,
vend e origjinë
m`i zgjodhe Ti...

veç vdekjen
të lutem shumë
lejomë ta zgjedh vet unë!..

05.07.2009 Bern

Natë!..

të këndoj
e s`di me ç`fjalë
të zgjoj një këngë
në këtë orë...

mbase as këngë,
mbase as fjalë,
mbase do Shpirti
kot të gjëmojë...

06.07.2009 Bern

Roje errësire...

pëllumbit i zunë pusinë,
pritarë të netëve-sterrë,
i ranë me plumba të helmët
tek priste Pranverën mbi degë...

i hapën një plagë në zemër,
një tjetër në shpirt e qëlloi,
po vdekur nuk ra në lëndinë,
as krahët në bar nuk i shtroi...

12.06.2009 Bern

Kënga e vdekjes...

shkrojtën poetët e lashtë,
shkrojtën nëdër shekuj e vite,
shkrojtën për fushat e nderit
dhe burrat si bar që kosite…

lavde e ndere të thurën
që nga Homeri i moçëm,
vargje të zgjedhur të thuri
dhe 1)Dritëroi i sotshëm…

lule parajse të thanë
në ballin e trimit të rënë,
po kurrë për vete s`të deshën,
as ëndrrash mik nuk të bënë…

1) Dritëro Agolli

29.05.2009 Bern

Mes udhësh...

u futa në radhë
meitësh
se desha njëherë
të vdes

po vdekja e lodhur qe
shumë
dhe mbeta mes udhësh
të pres!..

27.05.2009 Bern

Qiell!..

hap dyert e paqes
që paqe udhëtarët
                    të gjejnë...
dhe këngë pranverash
                    të mbrijnë
mbi dhimbjet e gjata
                    të mallit...

27.05.2009 Bern

Poezi!

ti nuk shtrohesh dot në letër
as me ligj as me dekret,
ti merr udhët në mesnatë
dhe ndër ëndrra më troket...

unë zgjohem marr fletoren,
nën jastëk e gjej dhe lapsin,
pastaj thur e shthur gjithë natën
gjr të thur siç dua vargun...

18.05.2009 Bern

Ujku plak!

zuri qoshen Ujku plak,
shtriu këmbët gjërë e gjatë,
priste vdekjen t`i dorëzohet
pa jorgan, jastëk e shtrat...

nuk deshte t`i prekin ballë
as gajret për fund nuk desh,
“Ujk kam qënë” tha, sa qesh gjallë,
ndaj si Ujk dua të vdes`!..

16.05.2009 Bern

Fjala jote...

(Ukshin Hotit)

dhe në mos ardhç më asnjëherë
me zogjtë e malit në Pranverë
fjala e mbetur kazamatesh
do vi një ditë me zogjë të tjerë...

e do rrëfejnë zogjtë e shenjtë
në ç`anë të qiellit ke zënë vend,
dhe ti do zbresësh si Feniksi
dhe fjala jote do marrë dhenë...

15.05.2009 Bern

Ka sy!..

ka sy
që u ngjajnë përrenjëve
heshtin në kohë t`acarta
e zgjohen në pranverë...

ka sy
që u ngjajnë shkëmbinjëve,
jashtë bëjnë gjumë
brenda ulërijnë...

06.05.2009 Bern

Nën` e lashtë!..

megjithë dhimbjet
që kam në trup,
një plag` në Plavë
e një në Shkup,

dhe pse më therin
duar e këmbë
për ty Kosovë
do thur një këngë...

do thur një këngë
t`ia themi bashkë
se jam Shqipnia,
jam nën` e lashtë...

17.02.2009 Bern

Ohër...

ëhtë një rrap në mes të sheshit
gjoksin çarë si zgafellë,
ca nga shekujt që përcolli,
ca nga zjarret e rrufetë...

si një plak i lodhur kohësh
rri i heshtur Rrapi lashtë
se ç`gjëmim ka brenda shpirtit
nuk ka gojë që të flasë...

25.01.2009 Bern

Kitarë!

ti fle mbështetur
për një muri
si një i varur
në litar...

nën atë heshtje
gjëmon një zhurmë,
gjëmon një ëndërr,
gjëmon një mall...

09.01.2009 Bern

Dilemë

kam frikë të zgjohem!

më dhëmbin sytë
nga dritë e gënjeshtërt,

lotë më shkojnë
e më zhburrërojnë

frikë kam të shfaq
surratin në pasqyrë
se mund të më duket
mortja më e mirë...

09.01.2009 Bern

Ndoshta…

ndoshta nuk je aq e denjë
të më flejshë si lot në sy,
të më bëhesh fill pa krye,
të më bëhesh poezi...

ndoshta ti s`e meriton
të më futesh në çdo varg,
po s`e di ç`më trdhton shpirti
të ndjej pranë kur je aq larg...

27.12.2008 Bern

Paqe e shtirur...

rri si i ngrirë përballë makinës,
nuk gjej një fjalë të vë në letër,
kot kruaj ballin e fërkoj sytë
gurrë e mendimit sonte ka shterë...

shterën mendimet s`është çudi,
mbase pushojnë e zgjohen prapë
kur të cingrrojë ora e madhe,
kur të përndizen Sharr e Korab!..

22.04.2009 Bern

Një flutur...

një flutur e frikur
u ndal në supin tim
dhe deshte të vdiste aty
mbi krahët e mi...

nga ç`kohë fluturoi
nuk desha të di
mjafton që ajo fjeti
në krahët e mi...

02.07.2009 Bern

U rritën fëmijët e mi...

fëmijët e mi u rritën,
u rritën rreth vatrës së gurtë,
u rritën e këngë kënduan
në prehërin e gjyshit të urtë...

kënduan për udhët e nderit,
kënduan për brezat e lashtë
që s`fshehën kurrë kraharorët
kur derdheshin dimrat e mbrapshtë...

u them: mbarëvafshi fëmijë,
dhe udhët e nderit t`i gjeni,
po dorën e babit mbi supe
s`e patët, ndaj lus të më ndjeni...

18.10.2009 Bern

Vetmi...

labirint
i errët
mes syrit tim
            të verbër
dhe botës së mistertë...

12.10.2009 Bern

Pëlhurë e Penelopës...

ajo pëlqeu
me fije nderi
kohën të thurë
e shthurë,
dhe lidhi pisk
që nga Homeri
botën
tek një pëlhurë...

05.10.2009 Bern

Zvetënim...

temjanë tundimi digjen
në të paqes shtrat të shenjtë
dhe shën Pjetri sheh nga qielli
shenjtoret në “zijafet”

dhe sheh zhveshur Penelopën
mes orgjish një Odise
i përmjer pastaj shtaron
Homerit që fle nën Dhé...

05.10.2009 Bern

Ëndërr...

dikur kam dashur të jem i lirë,
të jem një erë me fërshëllimë,
të ik mes pyjesh si egërsirë,
të rri nën hënë të ulërij...

të jem i lirë desha dikur,
të rend pas yjesh si një i marrë,
të më gjëmojë një këng` e mitur
gjer të gjej paqen poshtë nën varr...

dikur e sot jan` largë shumë,
sot e dikur nuk piqen kurrë,
po mbeti ëndrra brenda tek unë
që më prish paqen edhe në gjumë...

11.01.2010 Bern

Ti...

ti ishe hënë
që hidhje dritë
në syt e mi...

po ç`isha unë
në syt e tu...

sikur ta di...

11. 01.2010 Bern

Sy të lodhur...

ëndërroj lotë qielli
tek rrjedhin nga strehët në Maj,
dhe bëhem vet rè e mbushur
kur gjumi më ik më pastaj...

ëndërroj këngë lumi
tek zbresin rrëmbishëm në Maj,
dhe bëhem vet gurgullimë
kur gjumi më ik më pastaj...

ëndërroj sy të lodhur
tek zvargen pas ëndrrash në Maj,
dhe bëhem vet lot i tyre
kur gjumi më ik më pastaj...

ëndërroj...

10. 01.2010 Bern

Kam dëshirë...

kam dëshirë të jem erë
breg më breg të fërfërij,
të zgjoj ëndrrat si një herë,
në të shpirtit shkretëtirë...

të jem erë kam dëshirë,
të puth dallgët mbi lumenj,
të jem këng` e errësirës,
shpirti natës të më ndjejë...

të më ndjejë çdo lëndinë,
të më ndjej` çdo fije bar,
tek rënkon ndër ëndërrime
të më ndjejë gjiri i saj...

05. 02.2010 Bern

Shqipëri!..

kur më rrihte plagët era,
kur më shponte kraharorë,
dhe kur krimbi dëshpërimit
brenda shpirtit ngrinte kokë,
nderi yt më shtrinte dorën,
emri yt më bënte zot...

kur më rrihte erë e mallit,
kur më diqte dejt e zemrës,
dhe kur krimbi dëshpërimit
po m`i brente yjt e shpresës,
nderi yt më shtrinte dorën
ballëpërballë të flas me erën...

22. 03.2010 Bern

Pa titull...

një pyll i errët
dëshpërimi
i duhet dhimbjes
për fole...

e që të mbushë
ëndrrat me kob
mjafton të çelë
vetëm një zog...

17. 03.2010 Bern

Erë...

sa herë
m`i shembe
fidanët e rritur
nëpër dhimbje kohësh!..

sa herë
m`i vrave
zogjtë në fluturim!..

saherë, saherë
në gjoks të kam pritur
o e çmëndur erë!..

20. 03.2010 Bern

Ti

(Mirjamit trevjeçare)

ti s`më kupton e vogla ime,
ti nuk e di se ç`kam në gji,
ti vjen me vrap në dhimbjen time
e bëhesh dhimbje edhe ti...

ti vjen më merr si një të humbur
që fatin pret në ndonjë udhë,
dhe nis e qesh si engjëllushe
kur pas të ndjek i bindur unë...

ti nuk e di e vogla ime
se kam në gji një gur të rëndë,
më presin tej në anë të botës
kështu si ti ca zogj me këngë...

07. 04.2010 Bern

E desha jetën!..

e desha jetën edhe kur s`më deshte,
edhe kur pikonte kasollja me kashtë,
edhe kur në magje kish veç një kothere,
edhe kur në sofër prisnim pesë a gjashtë...

e desha jetën edhe kur më qeshte,
edhe me furtuna edhe me rrebesh,
po kishte dhe raste kur desha të vdes,
kur fliste i marri e duhej të hesht...

06. 04.2010 Bern

Lermëni të vdes!..

lermëni të ruaj paqen,
lermëni të ik në paqe,
lermëni o bij pilatësh,
lermëni të ik pa fjalë...

lermëni të ruaj shpirtin,
lermëni për perëndi,
lermëni o bij pilatësh,
lermëni të vdes njeri!..

09. 04.2010 Bern

Stinë e largët...

seç të ndjej o stin` e largët,
tek më fshihesh nëpër këngë,
siç e ndjen të detit dallgë
nga një breg një vark` e lënë...

seç të ndjej o stin` e largët,
brenda shpirtit seç të ndjej,
siç e ndjen një serenadë
pas kanatash një boem...

do të ndjej o stin` e mitur
afër Zotit gjer të vi,
siç e ndjen një i braktisur
mbi qerpikë një pik` shi...

19. 01.2010 Bern

Në qytetin tënd...

kam frikë të kthehem
në atë qytet. Kam frikë
nga frika se ende më pret...

kam frikë nga zhurma
e gjurmëve të tua,
kam frikë nga frika
se ende të dua...

25. 04.2010 Bern

Ik!..

nuk qaj për ty që do ikësh,
do ikësh se duhet të ikësh,
po qaj veç për yllin e fundit
në zemër që duhet të fikësh…

nuk qaj as për fjalën e fundit
nga dhimbje dëshpërimesh që zbriti,
veç qaj për aromën e flokut,
do qaj se më qan edhe shpirti!..

01. 04.2010 Bern

Ç`më gënjejnë sytë!..

ti nuk mund të jesh ajo,
as ajo nuk ishte “ti”
ti djeg sot me sy të blertë
dje ajo me sy të zi...

ç`më gënjejnë sytë që moti
herë ajo e herë ti
ah! -sikur të bënte Zoti
për të dyja një palë sy...

13. 06.2010 Bern

Etje...

jam vetëm me brengën,
digjem për një fjalë,
si zogu për këngë,
si bregu për dallgë...

s`jam më erë jugu,
s`jam as Lis për hije,
s`jam as gjeth as degë
o brenga ime brengë...

17. 05.2010 Bern

Përmbajtja:

1 Bashkudhëtar 5
2 Çamëri 6
3 Mbaj mend 7
4 Kur dheu i shenjtë kishte zjarr 8
5 Dy kapedanë 9
6 Gjurmë kohësh 10
7 Janinë 12
8 Këng` e besëlidhjes 13
9 Këng` e popullit tim 14
10 Ato bjeshkë janë tonat 15
11 Zemërova perënditë 16
12 Jam koha ime 17
13 Dhimbje arbërore 18
14 Baladë e fjalës 19
15 Kosovë 20

16 Qajnë dhe malet ndonjëherë 21
17 Një ditë 22
18 Qëndroni o këmbë të mia 23
19 Përpara ekranit 24
20 Gërshetë e shprishur 25
21 Kënga ime 26
22 Makinë e shkrimit 27
23 Natë e shurdhët 28
24 Klithmë stinësh 29
25 O Zot 30
26 Natë 31
27 Roje errësire 32
28 Kënga e vdekjes 33
29 Mes udhësh 34
30 Qiell 35
31 Poezi 36
32 Ujku plak 37
33 Fjala jote 38

34 Ka sy 39
35 Nën` e lashtë 40
36 Ohër 41
37 Kitarë 42
38 Dilemë 43
39 Ndoshta 44
40 Paqe e shtirur 45
41 Një flutur 46
42 U rritën fëmijët e mi 47
43 Vetmi 48
44 Pëlhurë e Penelopës 49
45 Zvetënim 50
46 Ëndërr 51
47 Ti 52
48 Sy të lodhur 53
49 Kam dëshirë 54
50 Shqipëri 55
51 Pa titull 56

52 Erë 57
53 Ti 58
54 E desha jetën 59
55 Lermëni të vdes 60
56 Stinë e largët 61
57 Në qytetin tënd 62
58 Ik 63
59 Ç`më gënjejnë sytë 64
60 Etje 65
61 Përmbajtja 66